PROGRAMI I INOVACIONIT PËR ARTE DHE KULTURE I ERIAC

THIRRJE PER APLIKIME

PROGRAMI I INOVACIONIT PER ARTE DHE KULTURE I ERIAC
Në përgjigje të shpërthimit global të Pandemisë Covid-19, e cila ka ndikuar ndjeshëm gjithashtu edhe në fushën e artit dhe kulturës Rome, ERIAC synon të forcojë qëndrueshmërinë e prodhuesve kulturorë duke mbështetur kreativitetin, frymën e inovacionit dhe vetë-qëndrueshmërinë.

Përmes iniciativave kulturore, Programi do të mbështesë zhvillimin e përmbajtjeve të reja të artit dhe kulturës, duke nxitur prodhimin-njohuri dhe transferimin-njohuri, promovimin e kreativitetit dhe vetë-qëndrueshmërisë së artistëve, sipërmarrësve dhe krijuesve Romë. Programi i Inovacionit të ERIAC:

- inkurajon ndikimin e qëndrueshëm afatgjatë;
- stimulon inovacionin, zgjuarsinë, krijimtarinë dhe virtytin e krijuesve Romë;
- kërkon të aktivizojë dhe mobilizojë skenën kulturore Rome per të krijuar, për të rritur, për të rigjeneruar, për të transformuar;
- rrit bashkëpunimin midis fushave kulturore, vendeve, identiteteve, gjinive dhe brezave, agjentëve të komunitetit, midis dhe përtej artit dhe kulturës Rome;
- kërkon efekt shumëfishues, duke përfituar drejtpërdrejt ose indirekt, familjet Rome, komunitetet dhe shoqëria maxhoritare në përgjithësi, duke përfshirë këtu edhe kontributet në nisma të tjera të vazhdueshme të udhëhequra nga Romët në këtë fushë.

Për të maksimizuar ndikimin e gjeneruar nga përmbajtja dhe njohuritë e reja kulturore, për t´i përhapur ato si burime kolektive dhe të arritshme, ERIAC do të shërbejë si një platformë për të shpërndarë, riprodhuar dhe promovuar nismat dhe rezultatet e tyre. Si bashkë-krijues dhe bashkë-prodhues, ERIAC do të përfshijë rezultatet e iniciativave të mbështetura në programimin e vet ndërkombëtar.

Programi është i strukturuar në 3 KATEGORI: DUKE SHKUAR NË KULTURË DIXHITALE, DUKE SHKUAR SI SIPËRMARRËS/E dhe DUKE SHKUAR ZGJUARSISHT. Sipas secilës kategori, aplikantët mund të aplikojnë për ´një herë´ kontribut **ndërmjet 2.500 - 5.000 euro** , për tu paguar me transfertë bankare. Iniciativat priten të zgjasin midis **3 - 6 muajve, filluar nga Korriku i 2020.**

1. DUKE SHKUAR NË KULTURË DIXHITALE (Iniciativa)
Meqënëse skena e artit dhe kulturës është duke e rigjeneruar veten në hapësirën dixhitale, ERIAC dhe partnerët e saj të projektit do të propozojnë përgjigje inovative artistike dhe kulturore për këtë realitet të ri. Duke u përqëndruar në ndikimin afatgjatë dhe në përgjigje të prirjes globale të kalimit në dixhital, ERIAC synon të mbështesë transformimin e arteve dhe individëve të kulturës Rome dhe individëve në hapësirë interneti. Në këtë kategori, ERIAC do të mbështesë krijimin e arteve dhe prodhimeve të reja të kulturës (të gjitha zhanret: përfshirë artet vizuale, animacionin, filmin, artet interpretuese, etj.) Si thelb të këtij tranzicioni, ERIAC inkurajon prodhimin e kundër-narrativëve në propagandën në rritje të së djathtës dhe anti-ciganizmit. Kreativiteti, të menduarit kritik dhe artet Rome janë strategji parësore të ERIAC-ut për të sfiduar valën e gënjeshtrave dhe jo-humanizimit, të jo-informimit dhe të keq-informimit për Romët, veçanërisht për gratë Rome.

2. 2. DUKE SHKUAR SI SIPËRMARRËS/E (Program Fellowship-i me Roma Entrepreneurship Development Initiative - REDI)
Mungesa e regjistrimit formal të krijuesve të artit dhe kulturës Rome, i bën këta prodhues kulturorë të papërshtatshëm për skemë mbështetjeje dhe fonde emergjente të prezantuara nga qeveritë

Ky Program Fellowship-i i zhvilluar në bashkëpunim me REDI-n, synon të mbështesë, trajnojë dhe mentorojë transformimin e arteve jo-formale dhe krijuesve të kulturës në sipërmarrës kulturorë. Në këtë mënyrë, ERIAC adreson sfidën që pjesa më e madhe e prodhuesve të artit dhe kulturës Romë të veprojnë si të pavarur, ku shumë prej tyre punojnë në ekonominë jo-formale.

3. DUKE SHKUAR ZGJUARSISHT (Iniciativa)
ERIAC synon të gjenerojë burime arsimore frymëzuese dhe të fuqishme për Romët dhe maxhorancën duke u përqëndruar në prodhim-njohurish dhe transferim-njohurish. Në këtë kategori, ERIAC do të mbështesë iniciativat që përqëndrohen në gjenerimin e njohurive të reja përmes hulumtimeve inovative, veçanërisht duke u përqëndruar në aspektet që lidhen me identitetin, kulturën, historinë dhe trashëgiminë Rome. Gjithashtu, DUKE SHKUAR ZGJUARSISHT do të mbështesë zhvillimin e metodologjive për transferimin e njohurive krijuese të drejtuar nga Romët, hartimin e materialeve për mësimin e identitetit Rom në kuadrin e arsimit formal dhe jo-formal. ERIAC inkurajon leksione, rishikime kritike, tekste dhe ese që reflektojnë në artet & kulturën aktuale të Romëve si dhe praktikë-identitetin.

Kriteret e pranueshmërisë

Aplikime nga të gjithë kandidatët që i përkasin grupit të kuptuar gjerësisht si Romani, pavarësisht kombësisë, vendit të banimit, gjinisë, paaftësisë, statusit martesor ose prindëror, moshës, fesë, besimit ose orientimit seksual.

Të gjithë aplikantët kërkohen të jenë kontribues aktivë në skenën e artit dhe kulturës Rome, në një nga 4 seksionet e tematikave te punës së ERIAC (artet dhe kultura; media; prodhimi i njohurive; historia dhe përkujtimi). Muzikantë, artistë, performues, artizanë, kineastë, profesionistë të mediave, kuratorë, edukatorë dhe hulumtues, dizajnerë, etj., janë të ftuar të aplikojnë. Kompanitë e artit dhe kulturës Rome (teatri, bende, etj.), kolektive artistike jo-formale, subjekte jo-fitimprurëse dhe sipërmarrje kulturore janë gjithashtu të inkurajuar të aplikojnë.

Të dy, anëtarët e asociuar të ERIAC si dhe jo-anëtarët kanë të drejtë të aplikojnë. Sidoqoftë, Komiteti i Përzgjedhjes do t´u japë përparësi anëtarëve aktualë të asociuar të ERIAC që kanë përmbushur parimin e kontributit. Përfituesit që nuk janë anëtarë të ERIAC do të ftohen të bëjnë kërkesë për ERIAC membership dhe të përmbushin principle of contribution.

Si të aplikoni?

Para paraqitjes së formularit të aplikimit, aplikantët inkurajohen të konsultohen me GUIDELINES documents (**të disponueshme në Anglisht dhe Romanes**).

Të gjithë kanditatëve u kërkohet të plotësojnë APPLICATION FORM, së bashku me CV-në (maksimumi 3 faqe). Gjithashtu mund të bashkëngjisni informacionet shtesë, siç janë portofolet, shembuj pune dhe dokumente mbështetëse.

Aplikimi mund të plotësohet **vetëm në Anglisht**. Ne ju inkurajojmë të përdorni shërbime të përkthimit në internet në rast se keni probleme në plotësimin e aplikimit online në Anglisht.

Aplikimi online mund të dorëzohet midis Maj 20 - Qershor 10, 2020.

Në rast se keni pyetje, ju lutem kontaktoni ERIAC përmes eriac@eriac.org duke shkruar në Subject: **ERIAC Innovation Program**

Më shumë informacion: www.eriac.org/eriac-arts-and-culture-innovation-program/

European Roma Institute for Arts and Culture - ERIAC

eriac_official_account

European Roma Institute for Arts and Culture

ERIAC
EUROPEAN ROMA INSTITUTE FOR ARTS AND CULTURE

PROGRAMI I INOVACIONIT PËR ARTE DHE KULTURE I ERIAC

REDI
Roma Entrepreneurship Development Initiative

OPEN SOCIETY FOUNDATIONS